

Njësia e Prokurimit

Istog: datë, 03.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Luard Mehmetaj B.I.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **LOT 1 - PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO PER NEVOJAT E KOMUNES SE ISTOGUT, LOT 2 - PUBLIKIMI I LAJMEVE NE PORTAL DHE NEVOJAVE TJERA PER PUBLIKIM TE KOMUNES SE ISTOGUT-633-023-023-221**, me Nr. të Prok: **633-23-3615-2-2-1**, Nr. të brendshem **633-023-023-221** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. HUDHET POSHTE SI E PA-BAZUAR, kërkesa për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik: **Luard Mehmetaj B.I.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **LOT 1 - PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO PER NEVOJAT E KOMUNES SE ISTOGUT, LOT 2 - PUBLIKIMI I LAJMEVE NE PORTAL DHE NEVOJAVE TJERA PER PUBLIKIM TE KOMUNES SE ISTOGUT-633-023-023-221**, me Nr. të Prok: **633-23-3615-2-2-1**, Nr. të brendshem **633-023-023-221**, kundër *Njoftimit për Kontrate*, të datës 14.04.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. *Vërtetohet* Njoftimi për kontratë i AK-se, i publikuar me datë: 14.04.2023.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin e Prokurimit ta vazhdoj*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues – sqaron se kërkesat- kriteret e vendosura në Njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit janë formuluar në harmoni me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj HUDHET POSHTE SI E PABAZUAR kërkesa për rishqyrtim.

- Autoriteti Kontraktues tek kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar:

Kerkesa 2- (vetëm për loto1) Operatori ekonomik duhet të ofrojë Dëshmi që ka frekuenca të regjistruara në organin përkatës-që mbulon territorin e komunës së Istogut
Dëshmia – Licenca valide për frekuenca të radios-kopje (që mbulon territorin e Komunes së Istogut)

Autoriteti Kontraktues- duke respektuar LPP, pra Paragrafin 1 dhe 2 të Nenit 7 të LPP, i trajton operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese.

Titulli i aktivitetit (LOT1- PUBLIKIMI I NJOFTIMEVE NE RADIO PER NEVOJAT E KOMUNES SE ISTOGU) tregon qartë se AK kërkon shërbime të Radiove për publikim të njoftimeve- e jo shërbimeve të Televizionit dmth të gjitha Radiot që kanë frekuenca të regjistruara që operojnë në Republikën e Kosovës e që kanë mbulueshmëri të territorit të komunës së Istogut mund të konkurrojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Pra ky kriter nuk diskriminon, nuk redukton e as nuk eliminon konkurrencën, por trajton në mënyrë të barabartë dhe shumë transparente të gjithë operatorët.

Autoriteti Kontraktues të Përshkrimi i çmimit të dosjes së tenderit , të lloj 1 keni kërkuar

8	VIDEO INCIZIME ME DRONE PER AKTIVITETET E KRYETARIT	HERE	40
---	---	------	----

poz.8 Video incizime me drone për aktivitete të kryetarit , si ka mundësi këto video incizime të shfaqen dhe të shihen në radio ?

AK KK Istog përveq që na ka diskriminuar në momentin që ka kërkuar Licence për Radio , duke kufizuar konkurrencën , edhe na anshkalur si Televizion lokal , dhe në përshkrim të çmimeve ka kërkuar një pozicion që nuk ka logjikë , për arsye se nuk ka ku të transmetohet .

- Tek Përshkrimi i çmimeve pozicioni Nr.8: VIDEO INCIZIME ME DRONE PER AKTIVITETET E KRYETARIT- Autoriteti Kontraktues kërkon nga Operatorët që të kryejnë shërbimet e krijimit të video-materialeve të cilat janë me interes që të publikohen në webfaqen e komunës, rrjetet sociale e që janë me interes të Komunes së Istogut dhe qytetarëve të Komunes së Istogut.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.


Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Gëzim Ademaj